

## 23 AMBASADORËT GREKË, ÇËSHTJA ÇAME DHE VORIO EPIRI

**Nga Dr. Xhavit Shala**

23 ambasadorë grekë të pensionuar, më datën 10 Tetor 2013, i janë drejtuar me një letër kryeministrit grek Antonis Samaras. Në atë letër ata këmbëngulin të tërheqin vëmendjen se, pavarësisht krizës ekonomike, Greqia nuk duhet të nënvleftësojë rolin prioritar të çështjes së saj kombëtare. E shprehur ndryshe, ata bëjnë thirrje për të risigurizuar kërcënimet dhe rreziqet ndaj sigurisë kombëtare të Greqisë, të cilat, sipas tyre, lidhen drejtpërsëdrejti në raportet me Turqinë, Maqedoninë, Shqipërinë dhe Qipron<sup>1</sup>.

Pavarësisht vellos diplomatike, propozimi i ambasadorëve për rivlerësimin e rreziqeve dhe kërcënimeve që gjoja vijnë nga vendet fqinjë si Turqia, Maqedonia dhe Shqipëria, bie ndesh me frymën e desigurizimit të këtyre rreziqeve, të filluar vite më parë në Ballkan, me integrimin euroatlantik të rajonit dhe me atë që vetë Greqia reklamoi në linjën e saj zyrtare si “lokomotivë” e këtyre proceseve në rajon. Letra e tyre, në një farë mënyre, është një mbështetje për partinë “Agimi i Artë” dhe programin e saj, një përpjekje për të larguar vëmendjen e opinionit grek nga kryqëzimi i kësaj partie, aksionet e së cilës po bien në vazhdimësi në merkaton politike greke. Është për të ardhur keq që këta ambasadorë, ish aktorë të rëndësishëm të politikës së jashtme dhe të sigurisë së Greqisë, edhe në vitin 2013, kanë mbetur skllëvër të ideologjisë perandorake bizantine të Megaliidesë.

Në letër, në raport me Shqipërinë, përveç amatorizmit në përgjithësi në fushën e historisë dhe keqinterpretimit me dashje të historisë së Shqipërisë, ambasadorët grekë kanë hedhur teza të tilla si: Shqipëria që kur është krijuar dhe deri tani nuk ka treguar një qëndrim miqësor ndaj Athinës, duke u bërë një shtet problematik për Greqinë; pas zhvillimeve pozitive për Tiranën në çështjet e Kosovës dhe Shkupit, rivaliteti i Tiranës me Athinën rritet gjithmonë e më shumë; shumica e politikës shqiptare e konsideron ardhjen e popullsisë çame në Shqipëri si çështje holokausti për shqiptarët si dhe në raportet me Shqipërinë Athina e ka lënë të ngrirë çështjen vorioepiriote, teza të cilat

---

<sup>1</sup> Shkrimi është botuar në “Gazeta Shqiptare”, datë 14 Nëntor 2013

lidhen me çështjet e sigurisë jo vetëm mes dy vendeve, por edhe më gjerë, me sigurinë në rajon.

Në të vërtetë krijimi i shtetit të pavarur të Kosovës dhe rritja e rolit të shqiptarëve në rajon, mbështetja e fuqishme amerikane ndaj faktorit shqiptar, përparimi i Shqipërisë drejt integritit euroatlantik, respektimi i standardeve ndërkombëtare për minoritetin grek në Shqipëri si dhe raportet në përgjithësi të mira zyrtare mes Tiranës dhe Athinës, vazhdon të shkaktojë nervozizëm në qarqet nacionaliste greke. Për pasojë, këto qarqe po hedhin hapa të pamatura dhe po vetëdemaskohen. I tillë është dhe veprimi i 23 ambasadorëve, nënshkrues të letrës ndaj kryeministrit Simitis.

Këto teza janë të lidhura me dy çështje kryesore, çështjen e pazgjidhur shqiptare në Greqi, e njohur dhe si çështja çame dhe pretendimet greke për të ashtuquajturin Vorio Epir. Gjithsesi, është me interes të trajtojmë këto teza secilën më vete.

### **1. Shqipëria që kur është krijuar dhe deri tani nuk ka treguar një qëndrim miqësor ndaj Athinës, duke u bërë një shtet problematik për Greqinë.**

Pavarësisht vellos diplomatike, kjo tezë e ambasadorëve do të thotë se Greqia e ka parë shtetin shqiptar që nga krijimi i tij e në vazhdimësi si kërcënim për sigurinë e saj dhe e ka sigurizuar në vazhdimësi atë. Letërënshkruesit e dinë se shteti grek, që në krijimin e tij, në zbatim të “Megali Idheas”, ka qenë mjaft aktiv kundër çështjes shqiptare. Greqia është përpjekur dhe ka përfituar padrejtësisht pjesë nga gjeohapësira shqiptare, në kufijtë e saj veriorë. Edhe Fuqitë e Mëdha, më shumë se një shekull më parë, e kanë parë me shqetësim tendencën dhe presionin e shtetit helen për të përfituar sa më shumë nga gjeohapësira shqiptare. Ato po e shikonin këtë politikë shtetërore si një investim të keq që Greqia po bënte ndaj sigurisë së saj. I pari që e shfaqti hapur këtë shqetësim ishte princi i Gjermanisë, Bismarku. “Ne mendojmë”, shprehej ai, “se ruajtja e paqes dhe e ardhmja e Greqisë do të përfitonin në rast se Greqia do të përfshinte në gjirin e saj sa më pak elementë shqiptarë që të jetë e mundur. Greqia nuk do të ishte në gjendje as t’i sundonte e as t’i asimilonte këta elementë. Qetësia e saj do të kërcënohej në qoftë se aneksonte një pjesë të madhe të kësaj race/kombësie luftarake dhe pak të nënshtrueshme”(letër e MPJ Francë dërguar legatës së saj në Athinë, 11 Shkurt 1881. Botuar në “Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”, Pjesa II, dok. Nr. 227, f. 436-438, Tiranë 1986).

Megjithatë grekët, në pamundësi për të penguar krijimin e një shteti shqiptar, ishin të bindur se bashkë me territoret shqiptare kishin importuar dhe një kërcënim të vazhdueshëm për sigurinë e vet. Nga ana tjetër edhe veprimtaria e shtetit helen ndaj kombit dhe gjeohapësirës shqiptare është vlerësuar si kërcënim ekzistencial nga ana e shqiptarëve dhe është sigurizuar në vazhdimësi prej tyre. Pra, shqiptarët dhe grekët në vazhdimësi e kanë mbajtur të sigurizuar njëri tjetrin, fakt i cili ka ndikuar negativisht dhe në sigurinë rajonale.

Por, është pranuar dhe nga vetë grekët e vërteta historike se, që përpara krijimit të shtetit helen, shqiptarët jo vetëm kanë mbajtur një qëndrim miqësor ndaj revolucionit grek, por kanë luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetje të tij, bile, në disa raste, në dëm edhe të vetë shqiptarëve. Kështu, nga shteti i Ali Pashës u nisën drejt revolucionit për pavarësinë greke heronjtë që e udhëhoqën atë, Bejko Zhulati, Marco Boçari, Karaiskaqi, Griva, Xhavella, etj., (Koçollari I, Policia Sekrete e Ali Pashës, V.2, F.282, Tiranë 2009). Nga oborri i Ali Pashës ka dalë dhe Koleti, kryeministri i parë grek (Aravatinos Spiridon P, 1895, f. 332) i cili njihet dhe si ideuesi dhe personi që e ktheu Megaliidenë në politikë zyrtare të shtetit grek.

Edhe pas krijimit të shtetit grek, sidomos në vitet 1877-1878, elita politike shqiptare është përpjekur që të krijojë marrëdhënie miqësore dhe aleancë mbi bazë partneriteti me qeverinë greke kundër Perandorisë osmane. Kështu, duke analizuar raportin e forcave në Ballkan, Abdyl Frashëri kishte arritur në përfundimin se, në kushtet e Krizës Lindore, aleati më i mundshëm i shqiptarëve ishte Mbretëria Greke. Prandaj, ai bëri disa tentativa për të bashkërenduar me qeverinë greke (Frashëri.K, "Abdyl Frashëri" f. 89-91. Tiranë 1984). Por, qeveria greke nuk hoqi dorë nga planet për jugun e Shqipërisë dhe bisedimet u ndërpre. Qeveria greke, duke përfituar pjesë të gjeohapësirës shqiptare dhe duke synuar për t'u zgjeruar në të ashtuquajturin Vorio Epir, ka investuar në vazhdimësi për ndërtimin e një modeli social armiqësor të marrëdhënieve me shqiptarët, duke ndikuar negativisht dhe në sigurinë në rajon. Kjo u provua dhe me implikimet e qarqeve nacionaliste greke në ngjarjet e vitit 1997 në Shqipëri. Pas kësaj duket paksa naive pritshmëria e 23 ambasadorëve grekë, nënshkrues të letrës ndaj kryeministrit Simitis, për një shtet shqiptar miqësor dhe jo problematik me Greqinë.

Megjithatë, pavarësisht kësaj, qëndrimi i shqiptarëve ndaj shtetit helen ndonëse nuk ka qenë miqësor, përgjithësisht nuk ka qenë as armiqësor. Kjo sepse gjatë gjithë historisë së shtetit shqiptar, bashkëpunimi dhe marrëdhëniet e mira me fqinjët dhe ekuilibri rajonal i fuqisë, si elemente të rëndësishme për paqe të qëndrueshme, kanë qenë si një shkollë politike dhe filozofi qeverisëse e shqiptarëve në raport me sigurinë rajonale, ndryshe nga shtetarët grek dhe të tjerë ballkanas të cilët si objektiv dhe filozofi qeverisëse kishin zgjerimin e territoreve.

## **2. Pas zhvillimeve pozitive për Tiranën në çështjet e Kosovës dhe Shkupit, rivaliteti i Tiranës me Athinën rritet gjithmonë e më shumë.**

Edhe kjo tezë e 23 ambasadorëve nuk qëndron. Ajo është një keqinterpretim me dashje i zhvillimeve pozitive rreth çështjes shqiptare në rajon. Është një tendencë djallëzore për të nxitur shtetin grek për të risiguruar padrejtësisht shqiptarët në rajon si kërcënim për interesat kombëtare të Greqisë. Duket se ambasadorët grekë nuk duan të pranojnë faktin se situata gjeopolitike dhe polariteti i fuqisë nga Ballkan ka ndryshuar. Evoluimi nga mendimi se paqja në Ballkan arrihej duke copëtuar trojet etnike shqiptare (shih deklaratën e Eduart Greyt mbi caktimin e kufijve të Shqipërisë në vitin 1913), deri tek bindja se pa zgjidhur çështjen shqiptare nuk mund të ketë paqe e siguri në rajon, ka qenë dhe është një zhvillim mjaft i rëndësishëm në procesin e zgjidhjes së Çështjes shqiptare, për rivendosjen e ekuilibrit të fuqisë në Ballkanit, me ndikime pozitive në vetë sigurinë rajonale.

Pra, nuk kemi të bëjmë me një rritje të rivalitetit të Tiranës me Athinën, por me korrigjimin e një gabimi historik të fuqive të mëdha, konkretisht atë të përjashtimit të shqiptarëve gjatë procesit të konfigurimit të ekuilibrit rajonal të fuqisë pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane.

Në llogaritjen dhe vendosjen e këtij ekuilibri në Ballkan, aktorët rajonalë dhe ndërkombëtarë që në fillim përjashtuan interesat kombëtare të shqiptarëve. Mosmarrja parasysh e këtyre interesave do të bënte që shqiptarët në vazhdimësi të kërkonin rivendosjen e ekuilibrit të fuqisë, ku ata të merreshin në konsideratë ashtu si aktorët e tjerë rajonalë. Refuzimi në vazhdimësi i këtyre kërkesave do ta bënte ekuilibrin e vendosur të ishte në vazhdimësi i brishtë dhe, për pasojë, paqja dhe siguria në rajon do të ishin në vazhdimësi të kërcënuara.

Edhe para se të kenë shtetin e tyre, shqiptarët kanë kërkuar që çështja e tyre të vlerësohej si një pjesë e rëndësishme e ekuilibrit politik dhe ekonomik në rajon. “Shqipëria e pavarur ...do të ishte dhe një element i ekuilibrit politik dhe tregtar, sepse do të ndalonte epërsinë ekskluzive të çdo fuqie tjetër dhe do t’ua mbante të gjithëve hapur rrugët e Lindjes”, do të shkruanin shqiptarët nga Shkodra në një memorandum dërguar lordit Bikonsfild, përfaqësuesit anglez në Kongresin e Berlinit. Por, memorandum i Shkodrës, si dhe dhjetëra kërkesa e protesta të tjera të nisura nga e gjithë gjeohapësira shqiptare, nuk u morën në konsideratë nga Kongresi i Berlinit në vitin 1878.

Ndërkohë, menjëherë pas këtij kongresi, numri i shqiptarëve prej 1.6-1.7 milionë banorë dhe madhësia e territorit në të cilin ishin popullatë e vetme apo shumicë dërmuese prej rreth 58 mijë kilometrash katrore të trungut etnik “është përafërsisht e njëjtë me numrin e serbëve dhe të grekëve dhe me madhësinë e trevave në të cilën ata jetojnë si popullsi e vetme a shumicë dërmuese, përkatësisht në përpjesëtim të drejtë me numrin e malazezëve dhe të rumunëve dhe me madhësinë e trevave në të cilat jetojnë si popullatë e vetme a shumicë dërmuese”(Qosja. R,“Çështja shqiptare. Historia dhe politika”, f. 27, Tiranë 1998). Siç vihet re, në Ballkan, midis kombeve, natyra kishte krijuar një ekuilibër natyror dhe gjeopolitik, për t’i siguruar rajonit një zhvillim normal në paqe e siguri pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane. Për këtë duhej që aktorët kryesorë ndërkombëtarë të kohës t’u njihnin edhe shqiptarëve të drejtën të kishin shtetin e tyre, njëjloj si fqinjëve të tyre ballkanikë dhe t’i përfshinin ata si aktorë pjesëmarrës në këtë ekuilibër. Edhe Bismarku, kancelari gjerman, tre vjet pas Kongresit të Berlinit, duket se ishte bindur më në fund se shqiptarët duheshin marrë në konsideratë si faktor ekuilibri, me ndikim në paqen dhe sigurinë në rajon (letër e MPJ Francë dërguar legatës së saj në Athinë, 11 Shkurt,1881). Por, Fuqitë e Mëdha dhe fqinjët zgjodhën rrugën e copëtimit të gjeohapësirës shqiptare. Në këtë mënyrë ata prishën këtë ekuilibër natyror e gjeopolitik në Ballkan, duke minuar paqen dhe sigurinë për një kohë të gjatë.

Fuqitë e Mëdha gjithashtu nënvleftësuan rolin e ekuilibrit rajonal të fuqisë në paqen dhe sigurinë në Ballkan. Ata menduan të ruanin vetëm ekuilibrin mes Fuqive të Mëdha të kohës dhe në funksion të saj viktimizuan Çështjen shqiptare në rajon. Vetë mikpritësi i Konferencës së Ambasadorëve në Londër, ministri i Jashtëm anglez, Eduard Grey, pas arritjes së marrëveshjes për caktimin e kufijve veriorë të Shqipërisë, më 17 prill 1913

deklaroi se “arritja e kësaj marrëveshjeje ishte esenciale për paqen në Europë dhe, sipas mendimit tim, ajo u arrit në kohën e duhur për të ruajtur paqen midis Fuqive të Mëdha”. Pra, fuqive të mëdha nuk iu interesonte ekuilibri rajonal i fuqisë. Kjo nuk u korrigjua as në konferencat e paqes të organizuara në përfundim të Luftës I dhe të Dytë Botërore.

Më pas, me përmbysjen e komunizmit dhe me prishjen e ekuilibre Lindje-Perëndim, çështjet nacionale në Lindjen komuniste dhe në Ballkan filluan të çliroheshin nga trysnia ideologjike. Si pasojë e prishjes së ekuilibrave të brendshme mes serbëve dhe kombeve të tjera, edhe Federata Jugosllave hyri në procesin e dizintegritit të dhunshëm.

Ky proces krijoi një situatë të re dhe shtoi shanset për ridimensionimin dhe zgjidhjen e Çështjes shqiptare në rajon, pasi në këtë federatë përfshiheshin rreth 40% të popullsisë dhe më shumë se gjysma e hapësirës gjeopolitike shqiptare në rajon. Por përsëri faktori ndërkombëtar përjashtoi trajtimin e Çështjes shqiptare nga Konferenca e Paqes e Dejtonit. Pas kësaj dhe vetëm pasi konsumuan pa sukses të gjitha rrugët paqësore për të kërkuar të drejtat e tyre, shqiptarët u detyruan të hidhen në lëvizje të armatosur në Kosovë në vitet 1998-1999 dhe në Maqedoni e në Luginën e Preshevës në vitin 2001.

23 ambasadorët grekë do të duhet të pajtohen me faktin se çlirimi i Kosovës nga pushtimi serb në vitin 1999, nënshkrimi i marrëveshjeve të Ohrit dhe Konculit në Luginën e Preshevës, në vitin 2001 dhe sidomos krijimi i shtetit të pavarur të Kosovës në vitin 2008, shënojnë fillimin e procesit të korrigjimit dhe rishpërndarjes së fuqisë në rajon në dobi të shqiptarëve. Kjo po con në rivendosjen e ekuilibrit të fuqisë në Ballkan, mes sllavëve, shqiptarëve dhe grekëve duke shënuar kështu një investim afatgjatë për paqen dhe sigurinë në rajon. Grekët, sllavët dhe shqiptarët nuk janë vetëm tre popuj bashkë në zonat e veta, “por janë tri qytetërime, me tri kultura, me tri gjuhë. Ballkani nuk mund të përfytyrohet, qoftë dhe pa njërin prej këtyre përbërësve.(Kadare I, Intervistë për revistën NIN të Beogradi, 25 Prill 2012)

Prandaj teza e ambasadorëve grekë se pas zhvillimeve pozitive për Tiranën në çështjet e Kosovës dhe Shkupit, rivaliteti i Tiranës me Athinën rritet gjithmonë e më shumë nuk është e saktë. Tirana nuk po rivalizon Athinën. Shqiptarët në rajon thjesht po zënë vendin e mohuar në ekuilibrin rajonal. Tashmë jo bipolariteti Beograd-Athinë, por tripolariteti Beograd-Tiranë-Athinë do të jetë kyç për paqen e sigurinë në Ballkanin Perëndimor.

### **3. Shumica e politikës shqiptare e konsideron ardhjen e popullsisë çame në Shqipëri si çështje holokausti për shqiptarët.**

Në të vërtetë 23 ambasadorët në këtë pikë janë më realistë. Çështja çame ka gjasa “që të ndiqet me energji nga çamët dhe përkrahësit e tyre të shumtë nga i gjithë spektri politik shqiptar”(International Crisis Group: “Albania, State of the Nation”, Europe Report nr. 871. 1 March 2000). Çështjen çame zyrtarisht e krijoi Konferenca e Londrës e vitit 1913. Mbetja e Çamërisë brenda kufijve të shtetit grek u konfirmua dhe legalizua përfundimisht edhe nga Konferenca e Paqes e Parisit e vitit 1919. Çështja e Çamërisë është pjesë e rëndësishme e Çështjes shqiptare në rajon, e cila nuk ka gjetur akoma zgjidhje. Si e tillë, ajo ka qenë në vazhdimësi e sigurizuar si nga shqiptarët, ashtu dhe nga grekët.

Shteti grek e vlerësonte si kërcënim për sigurinë e tij faktin që tokat e aneksuara prej tyre pranë kufirit më Shqipërinë nuk ishin greke dhe kishin popullsi shqiptare. Për këtë, ato duheshin bërë greke me të gjitha format dhe mundësitë. Që nga kjo kohë, qeveritë greke ndërhyjnë dhunshëm në këtë pjesë të hapësirës gjeopolitike shqiptare dhe nëpërmjet spastrimit etnik të shqiptarëve, kryesisht të besimit mysliman, arritën ndryshimin e raporteve demografike.

Kështu, nëndërmjet viteve 1921 dhe 1926 qeveritë greke kanë deportuar shqiptarët myslimanë nga Çamëria, në mënyrë që tokat e tyre t’ua jepte grekëve,(Raport i ICG-së për Europën, N°153, 25.2.2004, f. 27) të cilët ishin kthyer nga Azia e Vogël. Këta të ardhur, përfituan nga shpronësimet e tokës dhe u vendosën në shtëpitë e myslimanëve (Baltiotis, Lambros:“The Muslim Chams of Northwestern Greece”, European Journal of Turkish Studies, 12/2011, p.7).

Më vonë, në vitin 1944, qeveria greke bëri një masakër në rajon dhe dëboi 35.000 çamë për në Shqipëri dhe Turqi. Më pas, në vitin 1945, vazhdoi përsëri spastrimin etnik në zonën e Çamërisë. Në vitet 1945 dhe 1946 prokuroria greke dënoi më shumë se 2100 meshkuj çamë me pretekstin e bashkëpunimit me fashizmin dhe konfiskoi pasuritë e tyre. Napoleon Zervas, personi që drejtoi procesin e spastrimit etnik të çamëve “u konsiderua si një hero nga shteti dhe ka pasur një karrierë të mëvonshme si një anëtar i

shquar i sistemit politik” (Baltiotis, Lambros, po aty, f.16). Më pas autoritetet greke aprovuan një ligj për sanksionimin e shpronësimit të pasurisë së çamëve, duke cituar gjoja bashkëpunimin e një komuniteti të tërë “me forcat okupuese gjermane”(Raport i ICG-së për Europën, N°153, po aty). Këto prona kaluan në duart e grekëve. Në mënyrë të ngjashme u konfiskuan pronat e çamëve me dispozitat e reja ligjore ndërmjet viteve 1952 dhe 1959, dispozita të cilat mbeten në fuqi edhe sot.

Pas përmbysjes së komunizmit çështja çame ka përjetuar një ringjallje të menjëhershme. Komuniteti çam në Shqipëri tashmë është kompaktësuar dhe është organizuar politikisht për zgjidhjen e çështjes së tij. Çamët janë të përfaqësuar në parlamentin shqiptar me një grup deputetësh. Çështjen e tyre kanë arritur ta ngrenë në Parlamentin Europian dhe në institucione të tjera ndërkombëtare. Ky rigjallërim i çështjes çame dhe përfshirja e saj në axhendat politike në Shqipëri dhe Buksel është perceptuar nga ana e Greqisë si një kërcënim për sigurinë e saj. Për këtë, që në shtator të vitit 2004, “autoritetet greke njoftuan forcimin e zonave veriore ushtarake pranë kufirit me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Forcat e reja të këmbësorisë nga zonat lindore të vendit, u transferuan pranë kufirit grek me Shqipërinë dhe një njësi e raketave “Patriot” u zhvendos nga Athina në një bazë ushtarake ajrore pranë Selanikut, së bashku me një njësi të re të forcave ajrore”(Vickers, M:“The Cham Issue – Where to Now?”, p. 8, Defence Academy of the United Kingdom, Conflict Studies Research Centre, London 2007). Në të vërtetë, këto dislokime të përhershme, që dhanë përshtypjen “se Greqia ndjeu një kërcënim të mundshëm nga kufijtë e saj veriorë, në krahasim me kërcënimin tradicional nga ana e Turqisë në Lindje”(Vickers, M, po aty).

Duke hezituar të angazhohen në dialog për çështjen çame dhe duke u mjaftuar me deklarata se "nuk ka çështje çame", autoritetet greke duket se “fshihen pas gishtit”, megjithëse në Greqi ka “ndarje të forta ndërmjet Ministrisë së Jashtme, e cila e di se ajo ka për të marrë përfundimisht me këtë çështje, dhe Ministrisë së Mbrojtjes, e cila nuk bie dakord për të diskutuar çështjen” (Vickers, M, po aty, f.9). Megjithatë, vlerësimi nga ambasadorët se çështja çame është kthyer si një çështje holokausti për shqiptarët mund të merret edhe si thirrje për t’u ballafaquar me këtë çështje apo për ta lidhur atë me çështjen e të ashtuquajturit Vorio Epir.



Çështja çame është pjesë e rëndësishme e Çështjes shqiptare në rajon. Deri në një zgjidhje optimale të saj, kjo çështje do të vazhdojë të ndikojë në çështjet e sigurisë së dy shteteve, për pasojë dhe në sigurinë rajonale. Është në interes të Greqisë dhe të sigurisë së saj njohja dhe pranimi i çështjes çame, si dhe njohja e të drejtës së pronësisë dhe të shtetësisë së çamëve. Është e domosdoshme për Greqinë që “të hapen negociatat lidhur me rivendosjen e të drejtave të duhura për çamët”(Raport i ICG-së për Europën, N°153, 25 shkurt 2004, f. 4) dhe të provojnë të përpilojnë një marrëveshje të qëndrueshme dhe afatgjatë të kësaj çështjeje “para se kjo çështje të ketë marrë hov dhe ...kur ankesat legjitime të çamëve do të shndërroheshin në çështje më të thella kombëtare.(Raport i ICG-së për Evropën, N°153, po aty).

#### **4. Athina e ka lënë të ngrirë në raportet me Shqipërinë çështjen vorioepiriole.**

23 ambasadorët theksojnë në letrën e tyre se në raportet me Shqipërinë Athina e ka lënë të ngrirë çështjen vorioepiriole. Vetë termi “Epir i Veriut” është prodhuar nga propaganda greke pas vitit 1913, për të mbështetur politikën shtetërore dhe kishtarë të Megaliidesë, pas aneksimit nga Greqia të pjesës më të madhe të Epirit. Kjo propagandë zyrtare dhe kishtarë është përdorur në vazhdimësi për të indoktrinuar breza të tërë në Greqi. Të pretendosh sot se i ashtuquajturi si Epir i Veriut është tokë greke, kur vetë Epiri është njohur gjithmonë si tokë shqiptare tregon mos njohje të historisë dhe besnikëri ndaj ideologjisë ekspansioniste të Megaliidhesë.

Jo më kot Bismarku që në vitin 1881 propozonte që në vend të territoreve shqiptare, grekëve t’u jepej ishulli i Kretës. “Ishulli i Kretës... ka jo vetëm një sipërfaqe pothuajse të barabartë me pjesën shqiptare të Epirit, por, si për nga popullsia me shumicë dërrmuese greke, ashtu edhe për nga pozita gjeografike, ai paraqet përfitime thelbësore saqë nuk mund të krahasohen kurrsesi me Shqipërinë”(letër e MPJ Francë dërguar legatës së saj në Athinë, 11 Shkurt 1881, po aty).

Ta propozosh që çështjen e të ashtuquajturit Vorio Epir ta bësh strategji zyrtare të shtetit grek, siç propozojnë ambasadorët, dhe sidomos të rekomandosh përdorimin e saj si kusht për mbështetjen e Greqisë për anëtarësimin në BE, është një tendencë mjaft e rrezikshme dhe e destinuar të dështojë. Ky propozim synon maqedonizimin e marrëdhënieve shqiptaro-greke, çka do të rezultojë me një rritje të tensioneve, me pasojë kjo për sigurinë në rajon. Ky propozim bie ndesh gjithashtu me nivelin e tanishëm të

marrëdhënieve zyrtare shqiptaro greke. Për pasojë ky propozim absurd nuk ka gjasa të merret parasysh.

Në përfundim, thirrja e 23 ambasadorëve grekë për të risigurizuar kërcënimet dhe rreziqet ndaj sigurisë kombëtare të Greqisë, të cilat sipas tyre lidhen drejtpërsëdrejti në raportet me Turqinë, Maqedoninë, Shqipërinë dhe Qipron, bie ndesh me frymën e integritit euroatlantik të rajonit dhe me vetë politikën zyrtare greke. Ato janë një përpjekje për maqedonizimin e marrëdhënieve të Greqisë më fqinjët, me pasoja kjo për sigurinë e vetë Greqisë, të fqinjëve të saj dhe të gjithë Ballkanit.